

VENDIM
Nr. 432, datë 17.5.2017

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN NË
AGJENCINË PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL, PËR GRANTIN
“NËNPROGRAMI I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË
VOGLA DHE TË MESME (NMVM)”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 14, DATË 21.3.2017,
TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2017 për Ministrinë e Zhvillimit Urban, në programin “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, rishpërndahen për Agjencinë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, në zbatim të vendimit nr. 14, datë 21.3.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për miratimin e financimit për grantin “Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)”, të programit “Mbështetje për ekonominë”, si dhe të kalendarit me datën e fillimit të aplikimeve, për vitin 2017”, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave dhe Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Ministria e Zhvillimit Urban
Shpërndarja e fondeve buxhetore për Programin “Mbështetje për Ekonominë”

në lekë										
EQ	Gr	Kodi inst.	Emërtimi i Institucionit	Kap.	Programi	Llog. ekon.	Kodi i Thesarit	Kodi i projektit	Shuma	Emërtimi i projektit të investimit
PAKËSOHET										
001	94	1094001	Aparati I MZHU	01	06210	2310000	3535	M940115	400,000,000	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
Totali i pakësimeve									400,000,000	
SHTOHET										
01	87	1087021	AZHER	01	01150	2310000	3535	Kod I ri	400,000,000	Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
Totali i shtesave									400,000,000	

